**VENDIM**
**Nr.3, datë 13.7.1992**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërise, e përbërë nga:

| | | |
|---|---|---|
| Rustem Gjata | Kryetar | i Gjykatës Kushtetuese |
| Feti Gjilani | Zv/kryetar | i Gjykatës Kushtetuese |
| Veli Budo | Anëtar | i Gjykatës Kushtetuese |
| Thimjo Kondi | Anëtar | i Gjykatës Kushtetuese |
| Ylvi Myrtja | Anëtar | i Gjykatës Kushtetuese |
| Franc Jakova | Anëtar | i Gjykatës Kushtetuese |
| Natasha Sheshi | Anëtar | i Gjykatës Kushtetuese |

Në mungesë të anëtarëve Manol Konomi e Hilmi Dakli, për arsye shëndetësore, me sekretar Ylli Mahmuda, më datën 13.7.1992, shqyrtoi në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.1 që i përket:

KËRKUES: Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste.

OBJEKTI I KËRKESËS

Interpretimin e ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" lidhur me papajtueshmërinë e detyrës së deputetit me anë të anëtarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

GJYKATA KUSHTETUESE

Pasi dëgjoi relatimin e çështjes,

VËREN:

Me kërkesën datë 28.5.1992, drejtuar Gjykatës Kushtetuese, Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste, kërkon anullimin e zgjedhjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, pasi procedura e ndjekur për zgjedhjen e tij është në kundërshtim me dispozitat kushtetuese sepse:

1. Nëntë juristët nuk janë zgjedhur nga mbledhja e përbashkët, por veç e veç nga institucionet e drejtësisë.

2. Gjykata e Kasacionit dhe Prokuroria e Përgjithshme përfaqësohen në këtë Këshill nga titullarët e tyre dhe nuk ka përse të zgjidhen zëvëndësit e tyre.

3. Në përbërjen e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, janë zgjedhur dy deputetë gjë që vjen në kundërshtim me nenin 3 të ligjit "Mbi dispozitat kryesore kushtetuese".

Gjatë seancës gjyqësore, përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, hoqi dorë nga pika 1 dhe 2 e kërkesës së tyre, duke u kufizuar vetëm në heqjen e deputetëve si anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Sipas nenit 15 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992, "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", përveç personave që janë përcaktuar në ligj për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, duhet që si anëtarë të tjerë të jenë edhe "... 9 juristë të tjerë që për aftësitë e tyre të zgjidhen një herë në 5 vjet në mbledhjen e përbashkët të Gjykatës së Kasacionit dhe të Prokurorisë së Përgjithshme pa të drejtë rizgjedhjeje".

Sipas procesverbalit datë 11.5.1992, të administruar në seancë gjyqësore, ku është pasqyruar mbledhja e përbashkët e Gjykatës së Kasacionit dhe Prokurorisë së Përgjithshme, del se midis nëntë juristëve janë zgjedhur dhe juristë që aktualisht janë deputetë në Kuvendin Popullor. Qënia e këtyre deputetëve njëkohësisht edhe si anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është e papajtueshme.

Në nenin 3 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", thuhet shprehimisht se: "Parimi themelor i organizimit shtetëror është ndarja e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe atij gjyqësor".

Pra, qenia e deputetëve si anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që është pjesë përbërëse e

organeve të drejtësisë, e cënon këtë parim. Kjo çështje gjen mbështetje në nenin 5 të ligjit nr.7556, datë 4.2.1992 "Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë", ku thuhet: "Deputeti i Kuvendit Popullor nuk mund të jetë në të njëjtën kohë anëtar i zgjedhur apo i emëruar në organet lokale të pushtetit, të administratës shtetërore si dhe në organet e drejtësisë.

Duke analizuar sa më sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në konkluzionin, se detyra e deputetit është e papajtueshme me detyrën njëkohësisht edhe si anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Në këto rrethana kërkesa e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste është e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 24 pika 3 dhe nenit 25 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese",

VENDOSI:

Detyra e deputetit nuk pajtohet me qënien e tij në të njënjtën kohë si anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Ky vendim është i formës së prerë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Tiranë, më 13.7.1992